Kërkesa nr. 24

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data 10.5.2023
Nr. Prot 4909

**KËRKUES:** **KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**OBJEKTI:** Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ

**DREJTUAR:** **KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE**

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve,

Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, ka depozituar denoncimet regjistruar me numër 174 ID, 175 ID, 213 ID, 214 ID, 215 ID, 218 ID, 233 ID.

Janë administruar indicie për organizimin e 7 (shtatë) veprimtarive publike, nga 6 (gjashtë) institucione publike, për të cilat pretendohet se nuk janë raportuar në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim.

Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerëson se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat "dh", "f " dhe "n", pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t'u nisur hetimi administrativ.

Në vijim të procedurës administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vijoi hetimin administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike të paraportuar në ndërfaqe.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike email, informacion sqarues në lidhje me shkaqet

dhe rrethanat e kryerjes së shkeljevetë pretenduara.

Institucionet e denoncuara janë si më poshtë vijon:

1. **Denoncimet e regjistruara me nr. 174 dhe 175 ID ndaj Bashkisë Cërrik**
2. **Denoncimi regjistruar me nr. 215 ID ndaj Bashkisë Krujë**
3. **Denoncimi regjistruar me nr. 213 ID ndaj Bashkisë Devoll**
4. **Denoncimi regjistruar me nr. 233 ID ndaj Agjencisë Kombëtare të Pyjeve**
5. **Denoncimi regjistruar me nr. 214 ID ndaj Bashkisë Fier**
6. **Denoncimi regjistruar me nr. 218 ID ndaj Bashkisë Lezhë**

Në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se rasti objekt denoncimi regjistruar me nr. 174 dhe 175 ID ndaj personi përgjegjës për bashkinë Cërrik, përbën shkelje të nenit 92, pika 3, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 4, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se rasti objekt denoncimi regjistruar me nr. 213 ID, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Devoll, përbën shkelje të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, si dhe në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenit 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator", i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, marrjen e masës administrative ndaj:

a) **Z. Florenc Doka, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Cërrik, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë;**
b) **Z. Astrit Seferkolli, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Devoll, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë;**

- Nga të dhënat, rezulton se z. Florenc Doka, është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Astrit Seferkolli, nuk është përsëritës për shkeljen.

Bashkëlidhur kërkesës për vendosje të sanksionit administrativ, ju vëmë në dispozicion, provat si më poshtë vijon:

- Vendim nr. 469, datë 09.05.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- Denoncimi administruar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me nr. 174 dhe 175 ID për bashkinë Cërrik;
- Denoncimi administruar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me nr.213 ID për bashkinë Devoll;

- Provat link në rrjetin social Facebook për bashkinë Devoll: https://www.facebook.com/photo/?fbid=584770807014071&set=pcb.584770953680723

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Kopje: 3
Afati i ruajtjes: 5 vjet

Punoi:
E. Mema
I. Horanlliu
M. Koja
A. Lamçe
Y. Merkaj

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

# Kerkese per informacion, Bashkia Devoll (213)

denoncime <denoncime@kqz.gov.al>
Tue 3/28/2023 9:04 AM
To: astritseferkolli@yahoo.com <astritseferkolli@yahoo.com>
Cc: info@kriik.al <info@kriik.al>
Bcc: Ylli Merkaj <Ylli.Merkaj@kqz.gov.al>;Aurel Lamce <Aurel.Lamce@kqz.gov.al>;Madalena Koja <Madalena.Koja@kqz.gov.al>

Përshëndetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më datë 25.03.2023, në adresën e e-mail-it, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është dërguar raporti X i Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), për gjetjet dhe rekomandimet për javën 17 - 23 Mars 2023, lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve. Nëpërmjet këtij raporti, është është marrë indicie për organizmin e 1 (një) veprimtarie publike nga Institucioni Juaj.

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.
Denoncuesi pretendon si më poshtë vijon:

"Bashkia Devoll, në bashkëpunim me gjimnazin "Fuat Babani" Bilisht, zhvilluan sot një aktivitet me rastin e ditës ndërkombëtare të poezisë".

Prova link:
https://www.facebook.com/photo/?fbid=584770807014071&set=pcb.584770953680723

Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të na informoni për datën, orën, organizatorin, tematikën e aktiviteteve, pjesëmarrjen dhe mediatizimin, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni e këtij email-i.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

facebook.com/bashkidevoli/posts/pfbid0kAF6Yo5h6KU3LapUKcg6EsAwvUxEedq4wRK8Watyj6dNwjqxyeFnouU5U4niypwWl

Gmail Qendra e Botimeve... Free Online OCR - ... Kuvendi i Shqipërisë Ministria e Turizmit... RREGULLORE-E-BR... Çertifikatë për rënie... Pamja e dokumenti... Ligj Nr 92 2014 dat... LIGJ nr 8438 date 2...

Search Facebook

**Bashkia Devoll**
March 21 ·

Bashkia Devoll, në bashkëpunim me gjimnazin "Fuat Babani" Bilisht, zhvilluan sot një aktivitet me rastin e ditës ndërkombëtare të poezisë.📖🖊

Te ftuar special ne këtë aktivitet ishin :
Gerta Bandilli Becka(shkrimtarë) , Eris Rusi pedagog(shkrimtar).

Nxënesit e talentuar në fushën e letersisë i shtuan nuanca dhe emocione akoma më te bukura këtij takimi me interpretimet e tyre individuale,si dhe poezi të përzgjedhura nga miqtë e ftuar shkrimtarë!

Një falenderim i veçantë shkon për drejtorin dhe mesuesit e kësaj shkolle ,të cilët janë kurdoherë te gatshëm ,mikpritës dhe bashkëpunues për aktivitete te tilla letrare kulturore ,të cilat në thelb kane artin e fjales dhe nxitjen drejt edukimin estetik !🙏




https://www.facebook.com/photo/?fbid=584770557014096&set=pcb.584770953680723&__cft__[0]=AZX7hg6_j12cw0gans8Id17b7EQ-XgNJS646-1EVaalzm2twziWwJlbRLNmciWbqgX3gRF-6L3wtkUyyVPkIgWaXrXAdePdMvdHvq2_XrT4FMCTy8EWXP4D8AeKAN26VHAGVo8869GHFVZ...

73°F Mostly cloudy · Search · 4:27 PM 5/9/2023

facebook.com/photo/?fbid=584770520347433&set=pcb.584770953680723

Gmail | Qendra e Botimeve... | Free Online OCR - I... | Kuvendi i Shqipërisë | Ministria e Turizmit... | RREGULLORE-E-BR... | Çertifikatë për rënie... | Pamja e dokumenti... | Ligj Nr 92 2014 dat... | LIGJ nr 8438 date 2...

Search Facebook




This photo is from a post. View post

**Bashkia Devoll**
March 21

31 | 4

Like | Comment | Share

Most relevant

**Imbrie Ajce**
Suksese Elena
Like Reply 6w

Top fan
**Roza Babi Stena**
Suksese zemra e mamit lart e me lart
Like Reply 6w

**Elena Leonel**
SUPER!
Like Reply 6w

**Landa Hoxha**
Suksese Elena
Like Reply 7w

Write a comment...

174-175

# Kërkesë për informacion, Bashkia Cërrik (174)

Përshëndetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është depozituar denoncim nëpërmjet postës elektronike të datës 11.03.20233, nga KRIIK ALBANIA ku pretendohet se:

"*Bashkia Cërrik ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 4 mars 2023 zhvillimin e aktivitetit me temë "Inspektim ne kantierin e zbatimit te infrastruktures publike Dasar", të planifikuar për t'u zhvilluar në datën 10 mars 2023.Drejtuesi politik i Qarkut Elbasan, z. Damian Gjiknuri në datën 6 mars 2023 ka postuar në faqen e tij në Facebook foto dhe video të zhvillimit të aktivitetit me tekstin:*
*"Banorët e fshatit Dasar në Njësinë Administrative Mollas së shpejti do kenë gati rrugën e re me të gjitha standardet.Ky investim, një kërkesë e kahershme e komunitetit, ishte tepër i domosdoshëm edhe për fermerët të cilëve u krijohet mjaft lehtësi për transportin e prodhimeve të tyre.Realizimi i projektit që përfshin ndërtimin e mureve mbajtës dhe asfaltimin e rrugës vjen edhe falë mirëmënaxhimit të fondeve nga bashkia Cërrik dhe kryetari Andis Salla i cili taksat e qytetarëve i përkthen në investime për ta.Në Njësinë Administrative Mollas para pak kohësh ka përfunduar edhe rrjeti ujësjellës që furnizon me ujë 24 orë në ditë të gjithë zonën.*

*#TëBashkuarJoTëNdarë#ShqipëriaeArdhmjaJonë#SkaKohëPërPushim*

*Zhvillimi i aktivitetit është postuar në datën 10 mars 2023 në faqen Facebook të Bashkisë Cërrik dhe në faqen Facebook të kryetarit të Bashkisë Cërrik Z. Andis Salla. Postimi ka përmbajtjen e mëposhtme: "DASAR Ku bashkë me Damianin inspektuam punimet që kanë nisur për rregullimin dhe afaltimin e rrugës së këtij fshati. Ky inevstim vjen si zgjidhje e një kërkese të kahershme të banorëve të këtij fshati, të cilën sot ne e realizojmë me fonde totalisht të Bashkisë Cërrik. #BashkiaCërrik#SkaKohëPërPushim#ShqipëriaeArdhmjaJonë"*

Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të na informoni për datën, orën, organizatorin, tematikën e aktiviteteve, pjesëmarrjen dhe mediatizimin, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni e këtij email-i.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kërko në Facebook

**Andis Salla - Faqja Zyrtare**
10 mars

📍DASAR

Ku bashkë me Damianin inspektuam punimet që kanë nisur për rregullimin dhe afaltimin e rrugës së këtij fshati. Ky inevstim vjen si zgjidhje e një kërkese të kahershme të banorëve të këtij fshati, të cilën sot ne e realizojmë me fonde totalisht të Bashkisë Cërrik.

#BashkiaCërrik
#SkaKohePerPushim
#ShqipëriaeArdhmjaJonë



https://www.facebook.com/photo/?fbid=645497467586628&set=pcb.645497657586609&__cft__[0]=AZXmcaR3VunGCYl8aGTBuW5fAEF055YdSjtqdeGgs9EOe2shlq3wp1dj0h0rbvZGm-YzzAuuZ4FObrVFob9xXs

# Inspektim ne kantierin e zbatimit te infrastruktures publike

Bashkia Cërrik Ujësjellës Kanalizime Cërrik | 04/03/23 | Aktivitetet e raportuara

Inspektim ne kantierin e zbatimit te infrastruktures publike Dasar

- Lloji i Aktivitetit: Inspektim/kontroll
- Data:: 10/03/2023
- Ora:: 11.00
- Vendi i Zhvillimit:: Dasar/NJA Mollas
- Shteti: Shqipëri
- Qarku: Elbasan
- Bashkia: Cerrik
- Njësia Administrative: Mollas
- Folësit kryesorë:: Damian Gjiknuri / Andis Salla
- Pozicioni: Drejtues Politik Qarku / Kryetari i Bashkise
- Pjesëmarrësit: Damian Gjiknuri / Andis Salla / administratori njesise/ komunitet
- Me pjesëmarrjen e medias?: Po
- I hapur për publikun?: Po
- Personi përgjegjës për raportim: Florenc Doka
- Personi i ngarkuar nga ligji për raportim (Sekretari i Përgjithshëm/drejtori përgjithshëm/drejtuesi më i lartë administrativ): Florenc Doka



© 2023 | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – Të gjitha të drejtat e rezervuara | Politikat e Privatësisë

## Kerkese per informacion, bashkia Cerrik (175)

Përshëndetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është depozituar denoncim nëpërmjet postës elektronike të datës 11.03.20233, nga KRIIK ALBANIA ku pretendohet se:

*"Bashkia Cërrik ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 25 shkurt 2023 zhvillimin e aktivitetit me temë "Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike", të planifikuar për t'u zhvilluar në datën 6 mars 2023.Drejtuesi politik i Qarkut Elbasan, Z. Damian Gjiknuri në datën 4 mars 2023 ka postuar në faqen e tij në Facebook foto dhe video të zhvillimit të aktivitetit me tekstin: "Banorët e fshatit Selvias në Njësinë Administrative Klos brenda muajit do kenë gati rrugën e re, një ndihmë e jashtëzakonshme për ta sepse përveçse shkurton distancën me qytetin, sjell edhe lehtësi në qarkullimin e automjeteve dhe transportin e prodhimeve.(...)".*

*Zhvillimi i aktivitetit është postuar në datën 7 mars 2023 në faqen Facebook të Bashkisë Cërrik dhe në faqen Facebook të kryetarit të Bashkisë Cërrik Z. Andis Salla. Nga kontrolli që u bë në kanalet zyrtare të informimit të titullarit dhe institucionit përkatës, nuk evidentohet asnjë postim tjetër online për zhvillimin e këtij aktiviteti. Pra, rezulton se aktiviteti është kryer dhe data e deklaruar për zhvillimin e tij, në ndërfaqen e raportimit të KQZ-së, ka qenë e plotësuar gabim."*

Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të na informoni për datën, orën, organizatorin, tematikën e aktiviteteve, pjesëmarrjen dhe mediatizimin, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni e këtij email-i.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kërko në Facebook

**Andis Salla - Faqja Zyrtare**
7 mars

SELVIAS

Bashkë me banorët e fshatit Selvias dhe drejtuesin politik të qarkut Elbasan Damianin, pamë nga afër punimet që kemi nisur për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës è këtij fshati. Ka vetëm pak kohë që ka nisur puna dhe ky investim i financuar tërësisht me fondet e bashkisë, përfshin shtrimin me asfalt, ndërtimin e mureve rrethues dhe pajisjen me ndriçim e trotuare sipas standardeve.

#BashkiaCërrik
#ShqipëriaeArdhmjaJonë
#SkaKohëPërPushim



# Inspektim ne kantierin e zbatimit te infrastruktures publike

Bashkia Cërrik Ujësjellës Kanalizime Cërrik | 25/02/23 | Aktivitetet e raportuara

Inspektim ne kantierin e zbatimit te infrastruktures publike Selvijas

- Lloji i Aktivitetit: Inspektim/kontroll
- Data:: 06/03/2023
- Ora:: 11.00
- Vendi i Zhvillimit:: Selvijas, NJA Klos
- Shteti: Shqipëri
- Qarku: Elbasan
- Bashkia: Cerrik
- Njësia Administrative: Klos
- Folësit kryesorë:: Damian Gjiknuri / Andis Salla
- Pozicioni: Drejtues Politik Qarku / Kryetari i Bashkise
- Pjesëmarrësit: Damian Gjiknuri / Andis Salla / administratori njesise/ komunitet
- Me pjesëmarrjen e medias?: Jo
- I hapur për publikun?: Po
- Personi përgjegjës për raportim: Florenc Doka
- Personi i ngarkuar nga ligji për raportim (Sekretari i Përgjithshëm/drejtori përgjithshëm/drejtuesi më i lartë administrativ): Florenc Doka



© 2023 | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – Të gjithë të drejtat e rezervuara | Politikat e Privatësise